

MAK ALBANIA sh.p.k
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 – 24

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për drejtimin dhe ortakët e Shoqërisë Mak ALBANIA sh.p.k

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **MAK ALBANIA sh.p.k** (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2017, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjes së përshkruar në bazat për opinion me rezervë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të **MAK ALBANIA sh.p.k** më datën 31 dhjetor 2017, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

Baza për Opinionin

Shoqëria është organizuar në tre divizione të ndara sipas natyrës dhe pozicionit gjeografik të aktivitetit. Këto divizione janë: (i) Zyra Qendrore - Mak-Construction; (ii) Mak Travel dhe (iii) Sheraton Tirana Hotel & Towers. Secili nga divizionet mban kontabilitet të veçantë dhe përgatit Pasqyrat e veta Financiare. Mak-Albania Shpk, përveç divizionit të Sheraton, i ka mbajtur llogaritë e divizioneve të tjera dhe i ka përgatitur Pasqyrat Financiare në USD.

Shoqëria ka bërë përkthimin e Pasqyrave Financiare të secilit divizion nga USD në Lekë duke përdorur kurset e këmbimit siç shpjegohet në shënimin 3 të Pasqyrave Financiare dhe jo sipas kërkesave të SKK 12. Për shkak të natyrës së regjistrimeve të shoqërisë ne nuk jemi në gjendje të masim efektet potenciale në Pasqyrat Financiare që mund të rrjedhin si efekt i politikës kontabël të aplikuar nga shoqëria.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbyshur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijmësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likujdojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare


Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomaliave materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënime shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënime shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

15 maj 2018


Irena Hoxha (Pulo)
Auditues Ligjor

MAK ALBANIA shpk
(Vlerat janë në Lek)
**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2017**

	Shënimet	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	267,262,912	955,993,007
Llogari të arkëtueshme	5	108,626,495	101,757,033
Aktive të tjera afatshkurtra	6	1,061,281	113,684
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	7	1,791,635	3,356,408
Inventari	8	17,111,909	13,769,916
Total aktiveve afatshkurtra		395,854,232	1,074,990,048
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	9	3,867,429,647	4,005,344,150
Total aktive afatgjatë		3,867,429,647	4,005,344,150
Total Aktive		4,263,283,879	5,080,334,198
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	10	272,195,000	314,016,500
Llogari të pagueshme tregëtare	11	98,954,790	112,504,926
Te pagueshme ndaj punonjësve	12	25,529,461	21,982,787
Detyrimet tatimore	13	3,913,458	8,103,153
Detyrime të tjera	14	65,457,896	69,827,749
Total detyrime afatshkurtra		466,050,605	526,435,115
Detyrime afatgjatë			
Hua afatgjatë	15	1,338,081,501	1,353,523,614
Provizione afatgjatë	16	5,615,145	6,203,403
Total detyrime afatgjatë		1,343,696,646	1,359,727,017
Totali i detyrimeve		1,809,747,251	1,886,162,132
KAPITALI			
Kapitali themeltar	17	11,907,024,000	11,907,024,000
Fitime të mbartura dhe rezerva		(8,619,385,304)	(7,628,563,887)
Fitimi i ushtrimit		(834,102,068)	(1,084,288,047)
Totali i kapitalit		2,453,536,628	3,194,172,066
 Totali i kapitalit dhe detyrimeve		 4,263,283,879	 5,080,334,198

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



MAK ALBANIA shpk

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	
Të ardhura	18	412,724,194	542,905,191
Të ardhura te tjera	19	114,305,672	105,584,402
Fitim/(Humbje) nga shitja e AAM-ve	20	-	(196,748,873)
Totali të ardhurave		527,029,866	451,740,720
Materiale të para dhe të konsumueshme	21	(241,586,565)	(272,338,656)
Shpenzime personeli	22	(143,487,478)	(151,820,724)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	9	(169,892,697)	(266,405,356)
Shpenzime të tjera	23	(782,342,838)	(90,185,900)
Të ardhura të tjera nga rimarrja e provizioneve	16	-	115,300,985
Fitimi operativ		(810,279,712)	(213,708,931)
Fitim/Humbje nga shitja e investimeve	24	-	(818,107,711)
Te ardhura dhe shpenzime financiare nga interesi	25	(23,389,261)	(23,491,274)
Fitimi dhe humbje nga kursi i këmbimit	25	(433,095)	(3,931,063)
Total shpenzime financiare		(23,822,356)	(27,422,337)
Fitimi para tatimit		(834,102,068)	(1,059,238,979)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	26	-	-
Fitimi/humbja e vitit		(834,102,068)	(1,059,238,979)
Te ardhura te tjera gjithperfshirese per vitin:			
Totali i te ardhurave te tjera gjithperfshirese per vitin		(834,102,068)	(1,059,238,979)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



MAK ALBANIA shpk

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

	Kapitali themeltar	Fitim i pashperndare dhe rezultati i vitit	Total
Pozicioni financiar më 1 janar 2016	11,907,024,000	(7,647,510,378)	4,259,513,622
Efektet e ndryshimit të kurseve të këmbimit gjatë konsolidimit		(6,102,577)	(6,102,577)
Fitimi neto për periudhën kontabël		(1,059,238,979)	(1,059,238,979)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016	11,907,024,000	(8,712,851,934)	3,194,172,066
Efektet e ndryshimit të kurseve të këmbimit gjatë konsolidimit		93,466,630	93,466,630
Fitimi neto për periudhën kontabël		(834,102,068)	(834,102,068)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	11,907,024,000	(9,453,487,372)	2,453,536,628

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 janë aprovuar nga administratorët dhe janë nënshkruar më 15 maj 2018 në emër të tyre nga:



Aprovoi



MAK ALBANIA shpk
(Vlerat janë në Lek)
**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	(834,102,068)	(1,059,238,979)
Axhustime për zërat jo-monetare:		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	169,892,697	266,405,356
Humbjanga shitja e Aktiveve Afatgjata Materiale	-	196,748,873
Humbje nga shitja e investimeve	-	818,107,711
Shpenzime për interesa	18,946,160	17,862,064
Levizje ne provizioneve	724,586,205	(115,300,985)
Fitimi operativ përpara ndryshimeve ne kapitalin qarkullues	79,322,994	124,584,040
<i>Ndryshimi ne kapitalin qarkullues</i>		
Ndryshimi ne inventar	(3,341,993)	8,572,807
Ndryshimi ne llogari te arketueshme dhe te tjera	(731,426,749)	50,822,274
Ndryshimi ne llogari te pagueshme dhe te tjera	(18,563,010)	(44,576,343)
Mjetet monetare te gjeneruara nga aktivitetet operative	(674,008,758)	139,402,778
Interesa te paguara	(18,946,160)	(17,862,064)
Mjetet monetare neto nga aktivitetet operative	(692,954,918)	121,540,714
Aktivitetet investuese		
Blerje te aktiveve afatgjata materiale	(31,978,194)	(54,708,287)
Shitje e aktiveve afatgjata materiale		490,835,013
Arketim nga shitja e investimeve		110,385,388
Arketim I huave te dhena	-	132,061,125
Mjete monetare te gjeneruara nga aktiviteti investues	(31,978,194)	678,573,239
Aktivitetet financuese		
(Ripagim)/ te hyra nga huate	(57,263,613)	(83,220,235)
Diferenca nga konvertimi I llogarive ne monedha te huaja	93,466,630	(6,102,577)
Mjete monetare te gjeneruara nga aktiviteti financues	36,203,017	(89,322,812)
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	(688,730,095)	710,791,141
Mjetet monetare ne fillim te periudhës	955,993,007	245,201,866
Mjetet monetare ne fund te periudhës	267,262,912	955,993,007

4

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Mak Albania Shpk është krijuar në vitin 1994, me vendim gjykatë Nr. 4453, datë 25 Maj 1994. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe nga statuti i saj.

Shoqëria ka NIPT J61821059A.

Selia e shoqërisë është Sheshi Italia, Ambjenti me Nr. pasurie 7/41, zona kadastrale 8160, Tiranë.

MAK ALBANIA Sh.p.k me 31 dhjetor 2017 ka patur ortakë si vijon:

- Heritage Glory Albania ltd, zoterues i 97 kuotave ose 97,98 % të kapitalit të kompanisë
- Fawzi M.A. Al Khurafi, zoterues i 1 kuote ose 1,01 % të kapitalit të kompanisë
- Mrs. Sabeeka Saád S Aljaser, zoterues 12.5 % të kuotave ose 0.1263 % të kapitalit të kompanisë
- Mr. Abdulmohsin J M A Alkharafi, zotërues i 13.46 % të kuotave ose 0.1360 % të kapitalit të kompanisë
- Mr. Loay J M A Alkharafi, zotërues i 13.46 % të kuotave ose 0.1360 % të kapitalit të kompanisë
- Mr. Eyad J M A Alkharafi, zotërues i 13.46 % të kuotave ose 0.1360 % të kapitalit të kompanisë
- Mr. Talal J M A Alkharafi, zotërues i 13.46 % të kuotave ose 0.1360 % të kapitalit të kompanisë
- Mr. Anwar J M A Alkharafi, zotërues i 13.46 % të kuotave ose 0.1360 % të kapitalit të kompanisë.
- Mr. Ahmad Jassim M A Alkharafi and zotërues i 13.46% të kuotave ose 0.1360 % të kapitalit të kompanisë.
- Mrs. Ghalia Jasem M A Alkharafi) zotërues i 6.73 % të kuotave ose 0.0680 % të kapitalit të kompanisë.

Në datë 05.02.2018 kuotat e shoqërisë janë blerë nga kompania Kastrati Sh.a.

Administratori i shoqërisë në datë e lëshimit të pasqyrave është Shefqet Kastrati.

Aktiviteti i saj është kryer nëpërmjet tre divizioneve kryesore: atij të ndërtimit, në Tiranë, divizioni i Hotelit Sheraton Tirana Hotel, dhe Mak Travel.

Emërtimi i Divizionit	Aktiviteti	Vendodhja
Mak Albania Construction	Ndërtim	Tiranë
Sheraton Tirana Hotel & Towers	Sherbim hotelerie	Tiranë
Mak – Travel	Agjensi Udhetimi	Linza

Në 31 dhjetor 2017 shoqëria ka 141 punonjës (2016: 141).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".



(Vlerat janë në Lek)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.



(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilin është kryer transaksioni, dhe më pas janë konvertuar në monedhën raportuese me një kurs fiks vjetor të përdorur nga shoqëria.

Aktivitet dhe pasivitet monetare në monedhë të huaj në datën e mbylljes së bilancit janë rivlerësuar në monedhën funksionale sipas kursit të shpallur nga Banka e Shqipërisë në datën e mbylljes së periudhës ushtrimore. Diferencat që rrjedhin si rezultat i rikonvertimit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Regjistrimet kontabël mbahen më vete për cdo division. Përveç divisionit të Sheratonit të gjitha divizionet e tjera i mbajnë regjistrimet në USD. Transaksionet janë kryer kryesisht në Lek (ALL), në EUR, dhe USD.

Transaksionet në monedhë tjetër nga Dollari Amerikan janë rregjistruar me kurs fiks si vijon:

Për përkthimin e Pasqyrave financiare nga Dollari Amerikan në Lekë janë përdorur këto rregulla për kurset e këmbimit si vijon: Llogaritë e Bilancit		Kurset e këmbimit të përdorura për përkthimin e PF në ALL	Kursi në Lekë
AAM	Hyrjet	Kursi i këmbimit që mbizotëron në ditën e transaksionit.	
	Daljet	Kursi mesatar i cdo kategorie të AAM në fillim të periudhës.	
Llogaritë aktive dhe detyrimet		Kursi i këmbimit i Bankës së Shqipërisë në datën e pasqyrave financiare.	111.1
Inventari dhe detyrimet ndaj shtetit		Kursi i këmbimit real i përdorur në hedhje	120
Kapitali	Kapitali i nënshkruar	Kursin historik.	
	Fitime të mbartura	Kursi mesatar i këmbimit përdorur në fillim të periudhës.	
	Humbje fitime të vitit	Mesatare ndërmjet kursit të të Ardhurave dhe Shpenzimeve të vitit ushtrimor.	
Të Ardhurat dhe Shpenzimet	Të Ardhurat	Kursi mesatar të hedhur	120
	Shpenzimet	Me kursin fiks të përdorur nga shoqëria	120

Përfundim nga ky rregull bëjnë zëra për të cilat është përdorur kursi historik sic janë parapagimet dhe amortizimi.

Rezultati nga diferenca e kurseve të këmbimit nga përkthimi i Pasqyrave Financiare nga Dollari Amerikan në Lekë mbarten në Pasqyrën e Bilancit. Këto diferenca janë paraqitur në grupin e Kapitaleve, si rezervë nga përkthimi i pasqyrave në monedhë të huaj.

Asetet dhe detyrimet jo monetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit.



(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël(vazhdim)

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj(vazhdim)

Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj që paraqiten me vlerën e drejtë përkthehen me kursin e këmbimit në datën kur vlera e drejtë është përcaktuar.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2017	2016
Euro/LEK	132.95	135.23
USD/ LEK	111.10	128.17

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë për llogaritë mbi bazën e interesit nominal.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi që mund të maten në mënyrë të besueshme.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerrret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me vlerën e drejtë duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit.



(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4 Aktive afatgjata material (vazhdim)

Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Norma e amortizimit %		Metoda e llogaritjes
	2017	2016	
Ndërtesa dhe instalime	3	5	
Makineri e pajisje	20	20	
Mjete transporti	20	20	Mbi Vlerën e mbetur
Mobilje orendi	20	20	
Pajisje elektronike	25	25	

Amortizimi nuk aplikohet për token dhe punimet në proces që nuk janë në funksionim.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.6 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

3.7 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15% (2016: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshem (apo të rikuperueshem) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshem në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.9 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.



(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.10 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.11 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.12 Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Arka	180,243	83,437
Banka	267,082,669	955,909,570
	<u>267,262,912</u>	<u>955,993,007</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Sheraton Tirana Hotel & Towers	24,661,153	16,925,127
Mak Albania Construction	83,677,411	83,854,874
Vilat	287,931	977,032
Mak- Travel	-	-
	<u>108,626,495</u>	<u>101,757,033</u>



5. Llogari të arkëtueshme tregtare (vazhdim)

5.1 Klientë për shitje dhe shërbime sipas natyrës

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Llogari të arkëtueshme tregtare	115,445,832	108,368,370
Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme	(6,819,337)	(6,611,337)
Llogari të arkëtueshme tregtare neto	108,626,495	101,757,033
Depozita garancie	-	-
	<u>108,626,495</u>	<u>101,757,033</u>

5.2 Humbjet nga zhvlerësimi i Kërkesave për Arkëtim të Sheraton Hotel

	2017		2016	
	Llogari të arkëtueshme	Zhvlerësimi	Llogari të arkëtueshme	Zhvlerësimi
Pa kaluar afati	24,554,248	(43,826)	17,230,263	(305,136)
61-90 ditë	505,310	(355,674)	61,234	(61,234)
91-120 ditë	87,670	(87,670)	-	-
121 - vazhdim	6,333,262	(6,332,167)	6,244,967	(6,244,967)
	<u>31,480,490</u>	<u>(6,819,337)</u>	<u>23,536,464</u>	<u>(6,611,337)</u>

Lëvizjet në zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme:

	31 dhjetor 2017
Gjendja në fillim	6,611,337
Krijimi i provizioneve	208,000
Rimarrja e provizioneve	-
Gjendja në fund	<u>6,819,337</u>

6. Aktive të tjera afashkurtra

Aktivitet e tjera afatshkurtra më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Të tjera kërkesa	859,816	113,684
TVSH e arkëtueshme	201,465	-
	<u>1,061,281</u>	<u>113,684</u>



MAK ALBANIA shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
(Vlerat janë në Lek)

7. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagime dhe shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Sheraton Tirana Hotel & Towers	1,730,285	3,238,102
Vilat	61,350	118,306
	<u>1,791,635</u>	<u>3,356,408</u>

Në zërin e parapagimeve përfshihet edhe vlera prej 891,513 Lek që përfaqëson parapagimin e tatimit ndaj fitimit të mbetur gjendje sipas sistemit të tatimeve më 31 dhjetor 2017. (2016: 992,988 Lek).

8. Inventari

Inventari detajohet si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Ushqime	7,434,651	4,459,867
Pije	2,222,999	1,735,494
Inventar operativ	7,454,259	7,574,555
	<u>17,111,909</u>	<u>13,769,916</u>



Handwritten signature

MAK ALBANIA shpk

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lek)

9. Aktive afatgjata materiale

	Toka	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Mjete transporti	Të tjera AMM	Në proces	Totali AAM
Kosto							
Gjendja më 1 janar 2016	153,383,380	8,128,524,527	1,541,112,843	12,476,992	1,222,160,605	-	11,057,658,347
Shtesa	-	23,188,055	-	-	31,520,232	-	54,708,287
Nxjerrje jashtë përdorimit	(40,059,868)	(1,119,742,547)	(98,991,764)	-	(220,114,917)	-	(1,478,909,096)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	113,323,512	7,031,970,035	1,442,121,079	12,476,992	1,033,565,920	-	9,633,457,538
Shtesa	-	10,039,417	733,231	-	10,444,132	10,761,414	31,978,194
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	113,323,512	7,042,009,452	1,442,854,310	12,476,992	1,044,010,052	10,761,414	9,665,435,732
Amortizimi i akumuluar							
Gjendja më 1 janar 2016	-	3,780,968,410	1,290,036,037	12,103,558	1,069,925,238	-	6,153,033,243
Amortizimi i vitit	-	183,616,106	49,690,985	74,687	33,023,578	-	266,405,356
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	(478,355,019)	(96,265,262)	-	(216,704,930)	-	(791,325,211)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	-	3,486,229,497	1,243,461,760	12,178,245	886,243,886	-	5,628,113,388
Amortizimi i vitit	-	100,636,677	39,731,864	59,749	29,464,407	-	169,892,697
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	-	3,586,866,174	1,283,193,624	12,237,994	915,708,293	-	5,798,006,085
Vlera neto kontabël							
Gjendja më 31 dhjetor 2016	113,323,512	3,545,740,538	198,659,319	298,747	147,322,034	-	4,005,344,150
Gjendja më 31 dhjetor 2017	113,323,512	3,455,143,278	159,660,686	238,998	128,301,759	10,761,414	3,867,429,647

MAK ALBANIA Sh.p.k
NUIIS: J61821059A

MAK ALBANIA shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
(Vlerat janë në Lek)

10. Hua afatshkurtra

Huatë afatshkurtra më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Hua Afatshkurtra (Overdraft)	272,195,000	314,016,500
	<u>272,195,000</u>	<u>314,016,500</u>

Overdrafti është marrë nga banka Credit Bank of Albania në shumën 2,450,000 USD me një normë interesi 4% + Libor.

11. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Sheraton Tirana Hotel & Towers	17,364,877	28,766,568
Mak Albania Construction	75,308,491	76,795,382
Vilat	6,281,422	6,942,976
	<u>98,954,790</u>	<u>112,504,926</u>

12. Llogari të pagueshme ndaj punonjësve

Marrëdhëniet kontraktuale të shoqërisë me punonjësit e tyre bazohen në kodin e punës të Republikës së Shqipërisë. Kontrata kolektive e punës dhe kontratat individuale janë lidhur ndërmjet shoqërisë dhe punonjësve të saj për përcaktimin e detyrimeve reciproke që lindin nga marrëdhënia e punës.

Detyrimet ndaj punonjësve përfshijnë detyrimin për pagën e muajit dhjetor si edhe provizione të lidhura me punonjësit. Shuma e tyre është 25,529,461 LEK për 31 dhjetor 2017 (2016: 21,982,787 LEK).

13. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore TAP	3,913,458	3,133,466
Tatimi mbi vlerën e shtuar	-	4,112,671
Detyrime të tjera	-	857,016
	<u>3,913,458</u>	<u>8,103,153</u>



MAK ALBANIA shpk
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
 (Vlerat janë në Lek)

14. Detyrime të tjera

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Shpenzime të konstatuara	14,892,843	18,758,732
Depozita për garanci	46,753,839	49,159,694
Të tjera	3,811,214	1,909,323
	65,457,896	69,827,749

15. Hua Afatgjata

Shoqëria ka marrë hua ndaj ortakëve me qëllim të financimit të investimeve si edhe për mbulimin e nevojave për kapital punues. Për këto hua nuk janë llogaritur apo paguar interesa. Gjendja e huasë më 31 dhjetor 2017 është 1,338,081,501 LEK (2016: 1,353,523,614 LEK).

16. Provizionet afatgjata

Provizionet afatgjata më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Gjendja në fillim	6,203,403	121,504,388
Krijimi i provizioneve	-	-
Rimarrja e provizioneve	(588,258)	(115,300,985)
Gjendja në fund	5,615,145	6,203,403

17. Kapitali themeltar

Kapitali i shoqërisë është 11.907.024.000 LEK i zotëruar nga:

	2017		2016	
	%	Kontributi në para	%	Kontributi në para
Heritage Glory Albania ltd	97.98	11,666,478,060	97.980	11,666,478,060
Fawzi M.A. Al Khurafi	1.01	120,272,970	1.010	120,272,970
Mrs. Sabeeka Saád S Aljaser	0.1263	15,034,122	0.1263	15,034,122
Mr. Abdulmohsin J M A Alkharafi	0.136	16,190,592	0.136	16,190,592
Mr. Loay J M A Alkharafi	0.136	16,190,592	0.136	16,190,592
Mr. Eyad J M A Alkharafi	0.136	16,190,592	0.136	16,190,592
Mr. Talal J M A Alkharafi	0.136	16,190,592	0.136	16,190,592
Mr. Anwar J M A Alkharafi	0.136	16,190,592	0.136	16,190,592
Mr. Ahmad Jassim M A Alkharafi	0.136	16,190,592	0.136	16,190,592
Mrs. Ghalia Jasem M A Alkharafi	0.068	8,095,296	0.068	8,095,296
TOTALI	100.00	11,907,024,000	100.00	11,907,024,000

18. Të ardhura

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga dhomat- të huajt	197,297,006	247,548,527
Të ardhura nga dhomat- grupet	77,435,785	112,150,633
Të ardhura nga dhoma të tjera	1,598,241	1,364,999
Të ardhura nga qera vilash	5,686,659	12,321,120
Të ardhura nga ndërtimi	-	1,046,400
Të ardhura nga ushqimi	108,669,685	117,788,325
Të ardhura nga ushqimi dhe pijet e përfituara	(1,337,932)	(1,967,950)
Të ardhura nga pijet - restoranti	23,374,750	25,826,340
Të ardhura nga shitja e duhanit etj	-	17,931,540
Të ardhura nga shitja e inventarit Linza	-	8,895,257
	412,724,194	542,905,191

19. Të ardhurat e tjera

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga qera dyqani dhe zyra	87,460,161	91,203,257
Të ardhura nga qendra e biznesit	14,518,810	-
Të ardhura nga telefoni dhe interneti	200,342	1,029,548
Të ardhura nga përdorimi i lavanderisë	1,820,329	3,240,943
Të ardhura nga pishina - klubi i shëndetit	9,564,209	8,150,973
Të ardhura të tjera	303,136	3,768,200
Të ardhura nga Pay TV	438,685	508,579
Humbje nga kursi i këmbimit	-	(2,317,098)
	114,305,672	105,584,402



MAK ALBANIA shpk
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
 (Vlerat janë në Lek)

20. Humbja nga shitja e aktiveve afatgjata materiale

Gjate vitit 2016 kompania ka shitur makinerite e pajisjet dhe mjetet e punës të divizionit Chateu Linza dhe MAK Construction. Të ardhurat dhe rezultati nga shitja e tyre paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga shitja e AAM-ve	-	490,835,013
Vlera kontabël neto e AAM-ve	-	(687,583,886)
Rezultati nga shitja e AAM-ve	-	(196,748,873)

21. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Kosto e Mallrave të shitura	39,347,771	55,748,197
Furnitura, nëntrajtme dhe shërbime	202,238,794	216,590,459
	241,586,565	272,338,656

22. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Pagat e personelit	127,559,659	135,401,665
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	15,927,819	16,137,647
Shpenzime të tjera të panjohura personelin	-	281,412
	143,487,478	151,820,724

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2017 është 141 (2016: 141).



MAK ALBANIA shpk
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
 (Vlerat janë në Lek)

23. Shpenzime të tjera

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Tarifa të ndryshme Sheraton	25,337,190	38,595,781
Shpenzime Marketing	6,946,113	7,234,645
Shpenzime borxh i keq	208,000	(353,477)
Taksa	13,917,550	15,159,420
Provizione	724,966,463	
Shpenzime të tjera	10,967,522	29,549,531
	782,342,838	90,185,900

24. Fitim/Humbje nga shitja e investimeve

Në vitin 2016 shoqëria ka shitur investimin e saj në pjesëmarrje të plotë në masën 100% në shoqërinë Alfa Butrinti sh.p.k. Vlera fillestare e investimit në pasqyrat financiare ishte 928,493,099 Lekë. Shitja e investimit është realizuar bazuar në kontratën e shitjes Nr.1016 Rep. Nr.371 kol datë 5 dhjetor 2016 në vlerë 110,385,388 ALL (864,885 USD).

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2016
Të ardhura nga shitja e investimeve	-	110,385,388
Vlera kontabël e investimeve	-	(928,493,099)
Rezultati nga shitja e investimeve	-	(818,107,711)

25. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatit nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Fitim nga kursi i këmbimit	24,568,523	16,750,200
Humbje nga kursi i këmbimit	(25,001,618)	(20,681,263)
Efekt neto nga kursi i këmbimit	(433,095)	(3,931,063)
Të ardhura nga interesat	699,634	2,017,878
Shpenzime për interesat	(18,946,160)	(17,862,064)
Efekt neto nga interesat	(18,246,526)	(15,844,186)
Komisione për kartat	(5,142,735)	(7,647,088)
	(23,822,356)	(27,422,337)



26. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Fitim/Humbja Para Tatimit	(834,102,068)	(1,059,238,979)
Shpenzimet e Pa zbritshme	803,891,632	(10,007,309)
Shpenzime në Favor të Personelit	378,388	899,999
Zhvlerësime/Provizione	208,000	-
Rimarrje Provizioni për shpenzime punonjësish	-	(115,881,846)
Gjoha Penalitete	15,000	15,000
Zhvleresime për llogari të tjera të arketueshme	724,966,463	-
Shpenzime pa dokumenta të rregullta tatimore	-	3,279,984
Shpenzime të tjera të panjohura	78,323,781	101,679,554
Fitimi i tatueshëm i periudhës ushtrimore	(30,210,436)	(1,069,246,288)

Shoqëria nuk ka njohur ndonjë aktiv tatimor të shtyrë në lidhje me humbjet e mbartura.

27. Evidentimi i diferencave ndërmjet të ardhurave në PASH dhe atyre të deklaruara në FDP

Rakordimi i të ardhurave	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura të deklaruara në PASH/ FDP tatim fitimi	527,029,866
Të ardhurat e deklaruara në FDP të TVSH	552,039,509
Diferenca	(25,009,643)
Contra rent	2,633,826
Ushqimi për stafin (pritet faturë dhe nuk deklarohet si e ardhur)	8,335,826
Mallra dhe shërbime të konsumuara nga stafi manaxherial	5,068,971
Skontot e aplikuar	1,392,355
Faturim për kreditim të pjesshëm	7,578,665
Totali	25,009,643
Diferenca	-

28. Transaksionet me palët e lidhura

Transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur me 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 është huat afatgjata nga ortakët për vitin 2017: 1,338,081,501 LEK. (2016: 1,353,523,614)

Shpërblimin total të dhënë stafit drejtues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 është 13,418,559 LEK (2016: 9,066,644 LEK).

Politika e vendosjes së çmimeve për transaksionet me palët e lidhura bëhet në bazë të kushteve të tregut.



29. Kontigjenca e angazhime

Hoteli është paditur nga tre ish-punonjës të tij për shkarkim të padrejtë. Një nga çështjet është e re për vitin ndërsa dy çështjet e tjera janë pranuar pjesërisht nga Gjykata e Apelit ë Tiranës për 2 paga mujore për çdo rast përkatës gjyqësor. Aktualisht çështjet janë në proces në Gjykatën e Lartë. Nuk ka asnjë vlerësim të saktë se cili do të jetë rezultati, megjithatë, shoqëria i ka provizionuar vlerat përkatëse.

Të hyrat e ardhshme minimale të qirasë lidhur me qiratë operative të paanullueshme janë si më poshtë:

	2017	2016
Deri në 1 vit	56,870,771	72,527,586
Deri në 5 vjet	51,006,905	86,102,059
	107,877,676	158,629,645

30. Ngjarje pas bilancit

Në datë 05.02.2018 kuotat e shoqërisë janë blerë nga kompania Kastrati Sh.a. Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

